



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 48 paragrafit 1 pika 3 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), nenit 40 paragrafit 3 nga Ligji për operacione valutore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11, 188/13, 97/15, 153/15 dhe 23/16) dhe pikës 9 nga Vendimi për mënyrën dhe procedurën e raportimit për transaksione me jorezidentë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/14), Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

UDHËZIM

për plotësimin e Udhëzimit për mënyrën e raportimit për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe huave ndërmjet kompanive të lidhura me kapital në bazë të investimeve nga jashtë

1. Në Udhëzimin për mënyrën e raportimit për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe huave ndërmjet kompanive në bazë të investimeve nga jashtë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 108/14 dhe 200/16), në pikën 3 shtohen dy paragrafë të ri me këtë përmbajtje:

“Ndërmarrjet në të cilat investohet janë të obliguara të njoftojnë Bankën Popullore për gjendjen dhe ndryshimet e kapitalit dhe huave ndërmjet kompanive të lidhura me kapital në bazë të investimeve nga jashtë, nëse janë të zgjedhura nga modeli për raportues, dhe në pajtim me aktin nënligjor i cili i rregullon mënyrën dhe procedurën e raportimit për transaksione me jorezidentë. Ndërmarrjet në të cilat investohet do të jenë të lajmëruara në mënyrë adekuate për përfshirje në model. Obligimi për raportim zgjat deri në shfuqizimin e saj me njoftim me shkrim nga ana e Bankës Popullore.

“Me përjashtim të paragrafit 1 nga kjo pikë, ndërmarrjet në të cilat investohet me formë organizative “shoqëri aksionare” lirohen nga obligimi të raportojnë për investimet e jorezidentëve - investitorëve-portfolio (më pak se 10% pjesëmarrje në aksionet e emetuara), përderisa për të gjitha llojet tjera të investitorëve (investitorë direkt, investitorë indirekt dhe investitorë me lidhshmëri horizontale në zinxhir) obligimi për raportim mbetet në fuqi”.

Paragrafët 1,2, 3,4, 5 dhe 6 bëhen paragrafë 3,4, 5, 6, 7 dhe 8.

Në paragrafin 1 i cili bëhet paragrafi 3 fjala: “Ndërmarrja” ndryshohet me fjalët: “Në pajtim me paragrafin 1 dhe paragrafin 2 të kësaj pike, ndërmarrja”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, dhe do të zbatohet nga data 1 janar 2018.

U nr. 38039
13.12.2017
Shkup

Guvernator
Dimitar Bogov